



www.qbz.gov.al

Buletini i Njoftimeve Zyrtare I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2019 – Numri: 13

Tiranë – E hënë, 1 prill 2019

PËRMBAJTJA

	Faqe
Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1810, datë 27.3.2019	Për shprehje interesi shërbim konsulence për “Asistencë teknike për të mbështetur hartimin e një strategjie të daljes nga skema për përfituesit e NE-së, bazuar në modelin inovativ dhe modelet ndërkombëtare të suksesshme”..... 3
Njoftim i Universitetit të Sporteve nr. 543, datë 26.3.2019	Për rishpalljen e procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit..... 4
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 5941, datë 30.10.2018	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Arben Zeqiri”..... 5
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 5944, datë 30.10.2018	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Elida-2017” sh.p.k. 6
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 5952, datë 30.10.2018	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Kurt Aruçi”..... 6
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 984, datë 1.2.2019	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Agrotek Farm TIK-TIK” sh.p.k. 6

Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 985, datë 1.2.2019	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Marion Stojku”	7
Vendim i Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit, Pyjeve, Ujërave dhe Turizmit, Dega Rajonale e Qarkut Tiranë, nr. 990, datë 1.2.2019	Vendim i Komisionit të Ankimit ndaj subjektit fizik/juridik “Zamir Gjeloshaj”	7

**KËRKESË**

Nr. 1810, datë 27.3.2019

**PËR SHPREHJE INTERESI
SHËRBIM KONSULENCE
PËR**

**“Asistencë teknike për të mbështetur
hartimin e një strategjie të daljes nga skema
për përfituesit e NE-së, bazuar në modelin
inovativ dhe modelet ndërkombëtare të
suksesshme”**

Ref. no. SAMP/CS/CQ/01-2019

*Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)**Hua No.: 8841- AL**Nr. i identifikimit të projektit: P162079*

Republika e Shqipërisë ka marrë një financim shtesë nga Banka Botërore nëpërmjet kostos së Projektit të Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP) dhe ka planifikuar të përdorë një pjesë të saj për shërbim konsulence. Shërbimi i konsulencës (“Shërbimi”) së kërkuar është “Asistencë teknike për të mbështetur hartimin e një strategjie të daljes nga skema për përfituesit NE bazuar në modelin inovativ dhe modelet ndërkombëtare të suksesshme”.

Shërbimet e konsulencës (“Shërbimet”) përfshijnë zhvillimin e një strategjie daljeje dhe një plan veprimi për përfituesit NE bazuar në modelin inovativ dhe eksperiencat ndërkombëtare duke zhvilluar dhe shfrytëzuar të gjitha burimet financiare qeveritare në çdo sektor, si bujqësia, transporti, komunat (projektet e komunitetit) etj. Ky shërbim kërkon një ekip të përbërë nga një drejtues ekipi, dy ekspertë socialë dhe një ekspert financiar me përvojë të gjerë në programet e asistencës sociale, preferohet programi i NE-së. Konsulenti pritët të fillojë shërbimin në prill 2019 dhe vazhdon deri në qershor 2019.

Termat e detajuara të Referencës (TOR) për këtë shërbim gjenden në faqen e internetit si vijon: <http://www.shendetesia.gov.al/kerkesa-per-shprehje-interesi/>

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, nëpërmjet Ekipit të Menaxhimit të Projektit SAMP fton të gjithë konsulentët legjitimë (“Konsulentë”) të shfaqin interesimin e tyre në ofrimin e shërbimeve të kërkuara. Konsulentët e interesuar duhet të ofrojnë

informacion, ku të demonstrojnë se ata kanë kualifikimet e kërkuara dhe eksperiencat e ngjashme për të kryer shërbimin e kërkuar.

Kriteret e shortlistimit janë:

1. Biznesi kryesor dhe vitet në biznes	20 pikë
2. Eksperienca specifike e firmës në fushën e shërbimit	40 pikë
3. Organizimi teknik dhe menaxherial i firmës	10 pikë
4. Numri i kontratave që kanë lidhje me shërbimin, të përfunduara gjatë tre viteve të fundit	30 pikë
Totali	100 pikë

Konsulentët e interesuar duhet të marrin në konsideratë politikën dhe klauzolat e Bankës Botërore në lidhje me konfliktin e interesit, e përcaktuar kjo në seksionin III, paragrafët 3.14, 3.16 dhe 3.17, të “Rregullave të Prokurimit të Bankës Botërore për Huamarrësit e FPI-së”, të datës korrik 2016 (“Rregullat e Prokurimit”).

Konsulentët mund të bashkohen me firma të tjera për të rritur kualifikimet e tyre, por duhet të tregojnë qartë nëse shoqata është në formën e një “joint venture” apo në formën e nënkontraktimit. Në rastin e një “joint venture”, të gjithë partnerët në “joint venture” do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe individualisht për të tërë kontratën, në rast se përzgjidhet.

Një konsulent do të zgjidhet në përputhje me metodën “Përzgjedhje Bazuar në Kualifikimet e Konsulentit – CQ”, në përputhje me procedurën e përcaktuar në Rregullat e Prokurimit.

Për më shumë informacion mund të kontaktoni në adresën e mëposhtme gjatë orarit zyrtar 08:00–16:30 nga e hëna deri të enjten dhe 08:00–14:00 të premten.

Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (dorazi, ose me e-mail) deri më **4 prill 2019**.

Ekipi i Menaxhimit të Projektit (PMT)**Projekti i Modernizimit të Asistencës Sociale (SAMP)****Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale – KATI I****“Rruga e Kavajës”, nr. 53, AL - 1001, Tiranë, ALBANIA****Në vëmendje të: Znj. Suzana Papadhopulli****e-mail: samp.papadhopulli@gmail.com**



NJOFTIM

Nr. 543, datë 26.3.2019

**PËR RISHPALLJEN E
PROCEDURAVE TË PËRZGJEDHJES SË
ANËTARIT TË BORDIT TË
ADMINISTRIMIT NË UNIVERSITETIN
E SPORTEVE TË TIRANËS**

Në zbatim të urdhrit të MASR-së nr. 41, datë 24.1.2019, *“Për njoftimin e fillimit të procedurave të përzgjedhjes së anëtarëve të Bordit të Administrimit, mënyrën e vlerësimit të kandidatëve dhe afatin e dorëzimit të dokumentacionit”*, në urdhrin e Rektoratit të Universitetit të Sporteve të Tiranës nr. 9, datë 21.3.2019, *“Për zhvillimin e zgjedhjeve për anëtarë Bordi Administrimi”*, në njoftimin e KIZ-it nr. 2, datë 21.3.2019, *“Kandidatët për anëtarë të Bordit të Administrimit”*, nga ora 9:00 deri në orën 15:00 në zyrën e protokollit të Universitetit të Sporteve të Tiranës rihapen procedurat e përzgjedhjes dhe të vlerësimit për të gjithë të interesuarit që do të aplikojnë në pozicionin e anëtarit të Bordit të Administrimit të UST-së. Afati i dorëzimit të dosjeve është pesë ditë pune pas shpalljes në faqen zyrtare të Ministrisë së Arsimit Sportit dhe Rinisë, në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare të Qendrës së Botimeve Zyrtare dhe në Buletinin e Agjencisë së Prokurimit Publik.

Kandidati aplikues duhet të plotësojë kërkesat si më poshtë:

a) Kërkesat e përgjithshme:

- Të jetë shtetas shqiptar.
- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar.
- Të ketë aftësi të mira komunikimi dhe të punës në grup.
- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse.
- Të mos ketë marrë masën disiplinore të largimit nga detyra në institucionet ku ka qenë i punësuar më parë.

- Të mos jetë i dënuar penalisht, me vendim gjyqësor të formës së prerë.

b) Kërkesat e veçanta që duhet të plotësojë kandidati:

- Të jetë person me profil publik dhe arritje të shquara brenda apo jashtë vendit në fushat akademike, menaxheriale, publicistike, ekonomike dhe juridike. Të ketë të paktën 10 vjet përvojë pune në fushat akademike, menaxheriale, publicistike,

ekonomike e juridike. Përparësi do të kenë kandidatët me përvojë praktike në sistemin e arsimit të lartë.

- Të ketë integritet etik dhe profesional.
- Të mos jetë i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

- Të jetë i padënuar ose ndaj tij të mos jenë dhënë masa sigurie apo dënim me vendim jopërfundimtar për kryerjen e krimeve, në përputhje me parashikimet e ligjit nr. 138/2015, *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të ndryshuar.

- Të mos ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të Shtetit para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”*.

- Të njohë të paktën një gjuhë të huaj.
- Të mos ketë konflikt interesi në përmbushje të kërkesave dhe dispozitave ligjore.

Lista e dokumentacionit, vendi dhe afati i dorëzimit që kandidati duhet të paraqesë

- Kërkesë për aplikim, ku të jetë specifikuar IAL-i ku kandidon

- Jetëshkrim i plotësuar në gjuhën shqipe (CV - Curriculum Vitae)

- Fotokopje të diplomës (përfshirë edhe diplomën “Bachelor”). Për diplomat dhe certifikatat e lëshuara nga institucionet e huaja të arsimit të lartë dhe institucione të tjera të autorizuar jashtë Republikës së Shqipërisë, të përcillet Vërtetimi i Njohjes dhe i Njehsimit të Diplomës / Certifikatës të lëshuar nga strukturat përgjegjëse përkatëse

- Fotokopje të librezës së punës
- Fotokopje të letërnjoftimit (ID)
- Vërtetim të gjendjes gjyqësore
- Vërtetim i lëshuar nga gjykata
- Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake, sipas formatit të shtojcës nr. 1/1

- Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit, sipas formatit të shtojcës nr. 1/2

- Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati, sipas shtojcës nr. 1/3

- Dëshmi e mbrojtjes së gjuhës së huaj
- Vetëdeklarim se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar i ish-Sigurimit të



Shtetit, para 2 korrikut 1991, në kuptimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”

Paraqitja e dokumenteve të cituara më sipër do të bëhet në një nga këto mënyra:

1. Me postë zyrtare në adresë të Universitetit të Sporteve të Tiranës.

2. Dorëzim dorazi në ambientet e zyrës së protokollit në Universitetin e Sporteve të Tiranës.

SHTOJCA nr. 1/1

Vetëdeklarim mbi mosangazhimin në funksione drejtuese partiake

Deklaruesi: _____

Unë, i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ i angazhuar në funksione drejtuese partiake.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA nr. 1/2

Vetëdeklarim mbi konfliktin e interesit

Deklaruesi: _____

Unë, _____ i nënshkruari _____, që po paraqes aplikimin tim për anëtar Bordi Administrimi në institucionet publike të arsimit të lartë, deklaroj se _____ në kushtet e konfliktit të interesit që parashikon ligji nr. 9367, datë 7.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar, dhe legjislacioni në fuqi për të ushtruar këtë detyrë.

Kjo deklaratë është hartuar me të dhënat në ditën e deklaramit.

Datë _____

Nënshkrimi _____

SHTOJCA nr. 1/3

Vetëdeklarim për verifikimin e vërtetësisë së dokumenteve të paraqitura nga kandidati

Unë, i nënshkruari _____, kandidat në procesin e konkurrimit për anëtar bordi në institucionet publike të arsimit të lartë,

autorizoj Ministrinë e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, të verifikoj në çdo kohë vërtetësinë e dokumenteve të paraqitura nga ana ime.

Datë _____

Nënshkrimi _____

REKTOR

Prof. Dr. Agron Cuka

VENDIM

Nr. 5941, datë 30.10.2018

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me nr. 9, datë 18.7.2018, të ISHMPUT-së, Dega Rajonale Tiranë, ndaj subjektit “Arben Zeqiri”, protokolluar me nr. 3963 prot., datë 2.8.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/ “b”/iii, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 9, datë 18.7.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 300.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Arben Zeqiri” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI

Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

**VENDIM****Nr. 5944, datë 30.10.2018****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 6 datë 23.4.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**Elida-2017**” sh.p.k., protokolluar me nr. 1871 prot., datë 26.4.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 5, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 6, datë 23.4.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 1.500.000 lekë, pezullimin plotësisht të aktivitetit dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Elida-2017” sh.p.k. ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj**

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

VENDIM**Nr. 5952, datë 30.10.2018****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar

me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 10, datë 4.8.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**Kurt Aruçi**”, protokolluar me nr. 4128 prot., datë 8.8.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/“q”, të nenit 38, të ligjit nr. 9385, datë 4.5.2005, “Për pyjet dhe shërbimin pyjor”. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendimit të dënimit nr. 10, datë 4.8.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë, në vlerën 80.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “Kurt Aruçi” ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

**KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj**

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

VENDIM**Nr. 984, datë 1.2.2019****I KOMISIONIT TË ANKIMIT**

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe Ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 14, datë 3.9.2018, të ISHMPU-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**Agrotek Farm TIK-TIK**” sh.p.k., protokolluar me nr. 5009 prot., datë 21.9.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në



përputhje me germën “b”/iii, të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”, i ndryshuar. Pasi shqyrtoi ankesën e subjektit dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 14 datë 3.9.2018 në vlerën 300.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

VENDIM

Nr. 985, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 11 datë 22.10.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**MARION STOJKU**”, protokolluar me nr. 6466 prot., datë 16.11.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën 1/“a”/iii të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative, në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimit nr. 11 datë 22.10.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale

Tiranë, në vlerën 500.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit “MARION STOJKU” sh.p.k., ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando LAMAJ

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

VENDIM

Nr. 990, datë 1.2.2019

I KOMISIONIT TË ANKIMIT

Në bazë të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 10433, datë 16.6.2011, “Për inspektimin në Republikën e Shqipërisë”, të VKM-së nr. 103, datë 4.2.2015, “Për krijimin dhe mënyrën e organizimit e të funksionimit të Inspektoratit Shtetëror të Mjedisit dhe Pyjeve”, i ndryshuar me vendimin nr. 338, datë 6.6.2018, të Këshillit të Ministrave dhe ankimit për vendimin përfundimtar me **nr. 11 datë 19.7.2018, të ISHMPUT-së Dega Rajonale Tiranë**, ndaj subjektit “**Zamir Gjelosaj**”, protokolluar me nr. 4386 prot., datë 29.8.2018,

Komisioni:

Sa më sipër nga analiza e fakteve të pretenduara nga të dyja palët arsyeton se marrja e masës administrative nga grupi i inspektimit është në përputhje me pikën “a”/iii, të pikës 1, të nenit 29, të ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, “Për lejet e mjedisit”. Pasi shqyrtoi ankesën dhe masën administrative në mbështetje të pikës 4, të nenit 137, të ligjit nr. 44/2012, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

Lënien në fuqi të vendim dënimi nr. 11, datë 19.7.2018, në vlerën 300.000 lekë dhe rrëzimin e ankimit të subjektit ndaj këtij akti administrativ.

Ky akt hyn në fuqi menjëherë.

KRYEINSPEKTORI
Armando Lamaj

Kundër vendimit përfundimtar mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë.

Buletini i Njoftimeve Zyrtare shpërndahet falas në çdo pikë të Postës Shqiptare.
Përmbajtja e Buletinit Zyrtar mund të konsultohet falas dhe pranë Qendrës së Botimeve Zyrtare.